

**FTESË PËR DORËZIMIN E PROJEKTEVE
SKEMA E INICIATIVAVE TË SHOQËRISË CIVILE (CSIS)
PËRKRAHJE PËR FUQIZIMIN E PUBLIKUT: INICIATIVAT E SHOQËRISË CIVILE PËR PËRFITIME
TË KOMUNITETEVE NË REGJIONET E GJILANIT DHE PRIZRENIT
NR: 01/2011**

Dhjetor 2011

FTESË PËR DORËZIMIN E PROJEKTEVE NR. 01/2011

SKEMA E INICIATIVAVE TË SHOQËRISË CIVILE (CSIS)

PËRKRAHJE PËR FUQIZIMIN E PUBLIKUT: INICIATIVAT E SHOQËRISË CIVILE PËR PËRFITIME TË KOMUNITETEVE NË REGJIONET E GJILANIT DHE PRIZRENIT

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e mëtejme “Misioni i OSBE-së në Kosovë”) bën thirrje për dorëzimin e aplikacioneve me qëllim të promovimit të iniciativave të shoqërisë civile që kanë për synim fuqizimin e publikut në regjionin e Gjilanit dhe regjionin e Prizrenit.

Skema e Iniciativave të Shoqërisë Civile (CSIS), e cila e përkrah programin për fuqizimin e publikut, do të ofrojë financim për akterë të shoqërisë civile në rajonet e Gjilanit/Gnjilane dhe Prizrenit në vlerë maksimale prej 7,000 euro, për adresimin e njëres nga fushat në vijim:

- 1. Fuqizimi i grupeve të cenueshme;**
- 2. Fuqizimi i pjesëmarrjes publike; dhe**
- 3. Përmirësimi i qasjes në shërbime komunale.**

Kompleti i plotë i dokumentacionit në **gjuhën angleze, shqipe dhe serbe** mund të merret në faqen e internetit të OSBE-së (<http://www.osce.org/kosovo>) nën pjesën Events.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në **gjuhën angleze** më së largu më **20 janar 2012, ora 12:00**, në zarf të mbyllur me shënimin “**No. OMIK 1/2011 – Proposal for CSIS - Do Not Open Before 20 January 2012**”.

Aplikacionet e dorëzuara me email dhe faks nuk pranohen. Aplikacionet duhet të dorëzohen në njërën nga adresat në vijim:

Misioni i OSBE-së në Kosovë, Prishtinë/Pristina	Qendra Rajonale e OSBE-së në Gjilan	Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren
Abdyl Frashëri, nr. 37 AKTASH 10000 Prishtinë, Kosovë	Rr. Idriz Seferi PN 60000 Gjilan Kosovë	Rr. Tirana PN 20000 Prizren Kosovë

Për më shumë informata ju lutem kontaktoni znj. Afërdita Pustina, nga Departamenti i Demokratizimit i Misionit të OSBE-së në Kosovë, përmes adresës: aferdita.pustina@osce.org

Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT CSIS.....	3
1.1.	Lansimi i iniciativës CSIS nga Misioni i OSBE-së në Kosovë	3
1.2.	Skema e Iniciativave të Shoqërisë Civile (CSIS) – Kosovë	4
2.	FUSHAT TEMATIKE	4
2.1.	Temat prioritare për grantet e vogla	4
3.	E DREJTA E APLIKIMIT	5
3.1.	Organizatat e shoqërisë civile me të drejtë aplikimi	5
3.2.	Projektet e pranueshme	5
4.	APPLICATION PROCEDURE.....	6
4.1.	Aplikimi	6
4.2.	Dorëzimi i projektpropozimeve	6
4.3.	Afati për t’iu përgjigjur ftesës	7
4.4.	Asistenca teknike për përgatitjen e projektpropozimeve.....	7
5.	VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKTPROPOZIMEV	7
5.1.	Hapi 1: seanca e hapjes dhe kontrollimi administrativ.....	7
5.2.	Hapi 2: Vlerësimi nga Komiteti Përzgjedhës i CSIS	8
5.3.	Hapi 3: Përzgjedhja/pranimi	9
6.	LISTA KONTROLLUESE PËR APLIKIM.....	9

1. PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT CSIS

1.1. Lansimi i iniciativës CSIS nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

Misioni në Kosovë i **Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)**, prania më e madhe vepruese e OSBE-së në terren, mes tjerash, punon për sigurimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe rendit publik për të gjithë.

Përmes Departamentit të vet të Demokratizimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet zhvillimin e mëtejshëm të një demokracie të qëndrueshme dhe të përgjegjshme në Kosovë. Ky Departament është i fokusuar në monitorimin e punës së institucioneve të Kosovës, në identifikimin e mangësive dhe në dhënien e këshillave për t'i tejkaluar ato. Më tej, ai u ofron institucioneve trajnime në vend të punës dhe mentorim, si dhe ndihmon në shkëmbimin e praktikave më të mira dhe ndërtimin e kapaciteteve. Përveç kësaj, Departamenti i Demokratizimit mbështet në jetësimin e reformës së qeverisjes lokale në Kosovë, përmes mundësisë të dialogut mes autoriteteve qendrore dhe atyre lokale, përmes ndërtimit të kapaciteteve në komuna dhe përmes shtimit të pjesëmarrjes së publikut në proceset e vendimmarrjes në komuna.

Seksioni për Qeverisje Lokale (LGS), pjesë e Departamentit të Demokratizimit, përkrah komunat në shtimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjes duke inkurajuar themelimin e mekanizmeve të ri dhe duke shfrytëzuar mekanizmat ekzistues, siç janë komitetet konsultative, organet e përfaqësimit nën-komunal, grupet e grave deputete dhe këshillat lokale për veprim të të rinjve. LGS ka për qëllim vetëdijësimin e publikut në lidhje me këta mekanizma dhe përmirësimin e qasjes së komunave ndaj qytetarëve të tyre, përmes projekteve të cilat i zhvillon në nivel komunal, regjional dhe nivel të Kosovës. LGS punon për të ngritur nivelin e dialogut që komunat e zhvillojnë me qytetarët e vet, në mënyrë që këtyre të fundit tu ndihmohet në shtimin e mundësive për të ndikuar në vendimmarrje. Qendrat regjionale të Misionit të OSBE-së anëmbanë Kosovës dhe LGS bashkërisht janë të fokusuar në sigurimin e përkrahjes për përfshirje të shoqërisë civile, e posaçërisht të grave, të rinjve dhe komuniteteve joshqiptare, në vendimmarrje në komuna.

Së këndejmi, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka sajuar **Skemën e Iniciativave të Shoqërisë Civile (CSIS)** për të përkrahur fuqizimin e publikut në komuna të përzgjedhura në rajonin e Gjilanit dhe Prizrenit¹.

Synimi i përgjithshëm i CSIS është që ta përkrah shoqërinë civile në sajimin dhe implementimin e projekteve të avokimit për shërbime qeveritare dhe në inkurajimin e bashkëpunimit me komunat e regjionit të Prizrenit dhe Gjilanit. Qëllimi i këtij projekti është që të adresojë nevojën për shtimin e ndikimit të shoqërisë civile në politikën dhe vendimmarrjen publike në Kosovë, që ka për qëllim përfundimtar shtimin e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe komunave si dhe stimulimin e krijimit të rrjeteve mes akterëve të shoqërisë civile. Në drejtim të arritjes së këtij synimi të gjithëmbarshtëm, CSIS ka të identifikuar rezultatet e mëtuara, si në vijim:

- Shtimi i bashkëpunimit mes institucioneve komunale dhe publikut në vendimmarrje në komunat e regjionit të Prizrenit dhe Gjilanit, i cili do jetë i dobishëm për të gjitha komunitetet.

¹ **Prizren region municipalities:** Mamusa / Mamushë / Mamuša, Suharekë / Suva Reka, Malishevë / Mališevo, Rahovec / Orahovac, Dragash / Dragaš, Shtimje / Stimlje

Gjilan/Gnjilane region municipalities: Gjilan / Gnjilane, Novobërdë / Novo Brdo, Partesh / Partesh, Hani I Elezit / Deneral Jankovic, Kacanik / Kacanik, Kamenicë / Kamenica, Viti / Vitina, Štrpce / Shtërpçë, Ferizaj / Urosevac, Klokot / Kllokot, Ranilug/Ranillug

- Inkurajimi i angazhimit të grave dhe grupeve të cenueshme shoqërore në bashkëpunim me komunat, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara.

1.2. Skema e Iniciativave të Shoqërisë Civile (CSIS) – Kosovë

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka filluar me implementimin e programit CSIS në maj të vitit 2011, me fonde të siguruara nga Misioni i Shteteve të Bashkuara pranë OSBE-së.

CSIS Kosovë financohet aktivitetet e shoqërisë civile të cilat adresojnë temat prioritare të përcaktuara më poshtë. **Shuma maksimale e financimit të cilat do të jepen përmes CSIS Kosovë është 7,000 euro për projekt.**

Është krijuar edhe komisioni përzgjedhës i CSIS, si një mekanizëm që siguron pjesëmarrje të gjerë në definimin e skemës dhe në procesin e përzgjedhjes të projekteve. Aktualisht Komisioni Përzgjedhës përbëhet nga përfaqësues të Projektit Zvicëran për përkrahje të qeverisjes lokale dhe decentralizimit në Kosovë (LOGOS); Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ); Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë.

1.3 Afatet kohore e programit

Në vijim është përmbledhur orari i përkohshëm i aktiviteteve të programit CSIS Kosovë:

Aktiviteti	Data
Afati për dorëzimin e aplikacioneve	E premte, 20 janar 2012, 12:00
Përzgjedhja e përfituesve të projektit	Janar 2012
Fillimi i implementimit të projektit	Shkurt 2012

2. FUSHAT TEMATIKE

2.1. Temat prioritare për projektet e vogla

Të gjitha projektet e dorëzuara nën CSIS duhet të kenë për synim njëra nga temat prioritare në vijim, të cilat ndërlidhen me përfshirjen e komuniteteve në vendimmarrje në komuna:

- **Tema prioritare 1: Fuqizimi i grupeve të cenueshme (të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet)**
- **Tema prioritare 2: Fuqizimi i pjesëmarrjes së publikut (transparenca në vendimmarrje komunale, informim publik dhe qasje ndaj publikut)**
- **Tema prioritare 3: Përmirësimi i qasjes në shërbime komunale (arsim, shëndetësi, regjistrim civil, etj.)**

3. E DREJTA E APLIKIMIT

3.1. Organizatat e shoqërisë civile me të drejtë aplikimi

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) me seli dhe veprimtari në regjionin e Gjilanit dhe Prizrenit² janë përfituesit primarë të synuar. Për këtë arsye, këto OSHC kanë të drejtë aplikimi për financim të CSIS.

CSIS do të pranojë aplikacione edhe nga OSHC formale edhe nga ato joformale (të regjistruara dhe të paregjistruara), megjithatë, pas përzgjedhjes parashihet se të gjithë aplikuesit fitues, nëse është e nevojshme, të regjistrohen si OJQ pranë Ministrisë së Administratës Publike, gjë që do t'i mundësojë OSBE-së që atë pjesëtar të shoqërisë civile ta trajtojë si partner implementues.

3.2. Projektet e pranueshme

CSIS është i hapur për aplikacione të projekteve brenda kontekstit vijues:

- Aplikacionet duhet të parashtrihen nga OSHC-të që ndodhen dhe funksionojnë në regjionin e Gjilanit dhe Prizrenit.
- Aplikacioni për projekt mund të dorëzohet nga një partneritet i OSHC. Në rast se partnerët e projektit përfshijnë institucione të cilat nuk kanë status të OJQ-së, institucionet udhëheqëse/nënshkruese duhet të jenë të regjistruar si OJQ.
- Projekti duhet t'i shërbejë interesave të komunitetit në komunat në vijim:

REGJIONI I PRIZRENIT	REGJIONI I GJILANIT
Prizren	Novobërdë
Mamusa / Mamushë / Mamuša	Partesh
Dragash	Kamenicë
Rahovec/Orahovac	Shtërpçë
	Kllokot
	Ranillug

- Çështja që duhet adresuar nga projekti duhet të ndërlidhet me **vetëm një** nga temat prioritare të identifikuar në nenin 2.1 (projektet duhet të fokusohen specifikisht në **një temë prioritare të vetme**, dhe nuk do të duhej të mëtojë t'i mbulojë disa tema përnjëherë)
- Projekti duhet të kanalizojë në mënyrë adekuate çështjet rinore dhe gjinore në temën prioritare të përcaktuar.
- Në pajtim me parimet e përcaktuara nga Komiteti Përzgjedhës i CSIS, nuk do të ketë limitime sa i përket numrit të aplikacioneve për projekte që mund të dorëzohen nga një OSCH e caktuar tek CSIS. Megjithatë, pa marrë parasysh numrin e aplikacioneve për

² **Prizren region municipalities:** Mamusa / Mamushë / Mamuša, Suharekë / Suva Reka, Malishevë / Mališevo, Rahovec / Orahovac, Dragash / Dragaš, Shtimje / Stimlje

Gjilan/Gnjilane region municipalities: Gjilan / Gnjilane, Novobërdë / Novo Brdo, Parteš / Partesh, Hani i Elezit / Deneral Jankovic, Kacanik / Kacanik, Kamenicë / Kamenica, Viti / Vitina, Štrpce / Shtërpçë, Ferizaj / Urosevac, Kllokot/Kllokot, Ranilug/Ranillug

projekte, secila OSHC me të drejtë aplikimi do të ketë të drejtë të pranojë financim (nëse përzgjidhet) për vetëm një projekt të caktuar brenda CSIS.

- Projekti nuk do të duhej të dyfishojë përpjekjet tjera aktuale. Posaçërisht duhet pasur kujdes që një projekt të mos përkrahjet nga më shumë organizata.
- Aplikacioni për projekt duhet të dorëzohet në gjuhën angleze.
- Financimi i kërkuar përmes aplikacionit për projekt nuk do të duhej të tejkalonte shumën prej 7,000 euro, ndërsa periudha e implementimit nuk duhet të jetë më e gjatë se 6 muaj, duke filluar në shkurt të vitit 2012.

4. APPLICATION PROCEDURE

4.1. Aplikimi

Për t'iu përgjigjur ftesës për dorëzimin e projekteve, OSHC-të e interesuara duhet të dorëzojnë Projektet e veta përmes **Shtojcës I: Aplikacioni për Projekt dhe Formatin e Buxhetit**. Projektet duhet të dorëzohen në gjuhën angleze. Misioni i OSBE-së në Kosovë nuk do t'i përkthejë projektet e dorëzuara në gjuhët tjera. Aplikuesit duhet t'i përmbahen rreptësisht formës së **Shtojcës I: Aplikacioni për Projekt dhe Formatin e Buxhetit** dhe ta plotësojnë formularin përkatës, ashtu siç sqarohet në formën e dhënë. Projektet nuk duhet të jetë më të gjata se dhjetë (10) faqe.

Projektet duhet të përmbajë formulime të qarta dhe formularët përkatës duhet të plotësohen sa më qartë që të jetë e mundur, në mënyrë që të jetë i mundur vlerësimi i projektit. Aplikacionet e pranuar dhe materialet e ndërlidhura me të duhet të jenë precize dhe të ofrojnë detaje të mjaftueshme për të siguruar qartësinë e projektit.

Aplikuesi gjithashtu duhet të ketë parasysh dhe të jetë i informuar për **Formularin e Marrëveshjes dhe Certifikatën e Përputhshmërisë** (nuk ka nevojë ta dorëzojë atë), i cili do të nënshkruhet mes OSBE-së dhe aplikuesve të përzgjedhur.

Aplikuesi gjithashtu duhet të dorëzojë **dokumentet përkrahëse** në vijim:

- Një kopje të certifikatës së regjistrimit të OJQ-së së tyre, nëse është në dispozicion
- Listën e stafit menaxhues kryesor
- CV-të e tërë stafit të propozuar të projektit
- Një marrëveshje apo protokoll të partneritetit, nëse projekti propozohet nga më shumë se një OSHC në partneritet.

4.2. Dorëzimi i projekteve

E tërë pakoja aplikuese, që përmban **Aplikacionin për Projekt dhe Formatin e Buxhetit**, si dhe dokumentet mbështetëse, duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur, me mbishkrimin **No. OMIK 1/2011 – Project Application for CSIS - Do Not Open Before 20 January 2012**

Aplikacionet për projekte duhet të dërgohen në adresat vijuese:

Misioni i OSBE-së në Kosovë, Prishtinë	Qendra Rajonale e OSBE-së në Gjilan	Qendra Rajonale e OSBE-së në Prizren
Abdyl Frashëri, nr. 37 AKTASH 10000 Prishtinë/Pristina, Kosovë	Rr. Idriz Seferi PN 60000 Gjilan/Gnjilane Kosovë	Rr. Tirana PN 20000 Prizren Kosovë

Aplikacioni për projekt duhet ta ketë emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit. Për aplikuesin është me interes që Misionit të OSBE-së në Kosovë t'ia ofrojë detajet e sakta kontaktuese, siç janë adresa postare, numri i telefonit dhe email adresa.

Aplikacionet duhet të dorëzohen personalisht. Aplikacionet e dërguara përmes faksit apo emailit nuk do të pranohen.

4.3. Afati për pranimin e aplikacioneve

Projektet duhet të dërgohen në njërën nga adresat e dhëna para orës **12:00 më 20 janar 2012**. Aplikacionet e pranuar pas skadimit të këtij afati do të refuzohen automatikisht.

4.4. Asistenca teknike për përgatitjen e Projekteve

Si pjesë e kornizës së CSIS për ngritjen e kapaciteteve, në regjionet e Gjilanit dhe Prizrenit është mbajtur një trajnim për menaxhim të projekteve për pjesëtarë të shoqërisë civile, ku u ofruan udhëzime për mënyrën e përgatitjes së projekteve. OSHC-ve pjesëmarrëse do tu ofrohen udhëzime shtesë gjatë periudhës së aplikimit lidhur me ftesën për dorëzimin e projekteve, nëse kjo kërkohet nga ato. **Megjithatë, këto udhëzime dhe ndihmesa nuk mund të interpretohen si siguri për përzgjedhjen e projektit përkatës.**

Për çfarëdo pyetje, udhëzime apo asistencë teknike në lidhje me CSIS, ju lutemi që para skadimit të afatit të aplikimit ta kontaktoni znj. Afërdita Pustina, në Seksionin për Qeverisje Lokale të Departamentit të Demokratizimit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, në adresën aferdita.pustina@osce.org.

5. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKTEVE

Nuk ka kufizime në lidhje me numrin e projekteve që një OSCH me të drejtë aplikimi mund t'i dorëzojë në kuadër të CSIS. Megjithatë, për sa i përket numrit të projekteve të dorëzuara, çdo OSCH do të ketë të drejtë të pranojë financim (nëse përzgjedhet) vetëm për një projekt specifik në CSIS.

Aplikacionet e dorëzuara duhet të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve në vijim:

5.1. Hapi 1: seanca e hapjes dhe kontrollimi administrativ

Para vlerësimit, aplikacionet do të kontrollohen nga Komisioni Përzgjedhës i CSIS për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me kushtet e pjesëmarrjes.

Aplikacionet që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 3 do të refuzohen automatikisht.

Aplikacionet do të refuzohen menjëherë në rastet në vijim:

- Nëse aplikacioni pranohet pas afatit;
- Nëse projekti nuk është me anë të Formatit të Aplikimit të Projektit të përfshirë në Shtojcën I
-
- Nëse buxheti i projektit nuk është dorëzuar në Formatin e Buxhetit të përfshirë në Shtojcën I.
- Nëse projekti nuk është dorëzuar në gjuhën angleze.

5.2. Hapi 2: Vlerësimi nga Komiteti Përzgjedhës i CSIS

Projektet në përputhje me kushtet do t'i dorëzohen Komitetit Përzgjedhës të CSIS për vlerësim. Vlerësimi i projekteve nga Komiteti Përzgjedhës i CSIS do të kryhet në pajtim me faktorët e notimit të dhënë në matricën vlerësuese më poshtë:

Faktorët e notimit	Nota e përgjithshme
<p>1. Relevanca e projektit</p> <p>1.1 A është identifikuar dhe përshkruar në mënyrë të qartë grupi i synuar?</p> <p>1.2 A ofron projekti një përshkrim të qëndrueshëm të përfshirjes së komunitetit në vendimet e komunës?</p> <p>1.3 A kanalizon propozimi çështjet rinore dhe gjinore?</p> <p>1.4 A ka bashkërendim mes projektit dhe nismave të tjera dhe projekteve aktuale?</p> <p>1.5 A ofron projekti zgjidhje kreative për çështjet e identifikuara?</p> <p>1.6 A ka tenduar aplikuesi ta kontaktojë komunën për të kërkuar kontribut në natyrë?</p>	30
<p>2. Implementimi dhe metodologjia e projektit</p> <p>2.1 A ofron projekti një përshkrim të qartë të asaj që projekti mëton të bëjë për t'i arritur rezultatet e pritura dhe synimet e projektit?</p> <p>2.2 A janë aktivitetet e propozuara adekuate dhe reale nga këndvështrimi kohor?</p> <p>2.3 A janë aktivitetet e propozuara praktike dhe konsistente me synimin dhe rezultatet e pritura?</p> <p>2.4 A përmban projekti indikatorë të verifikueshëm në mënyrë objektive për rezultatet e aktiviteteve?</p>	20
<p>3. Buxheti i projektit</p> <p>3.1 A janë shpenzimet e propozuara konsistente me projektin ?</p> <p>3.2 A janë shpenzimet e propozuara të domosdoshme për implementimin e aktiviteteve të projektit?</p> <p>3.3 A janë shpenzimet e propozuara të detajuara dhe transparente?</p> <p>3.4 A janë shpenzimet e propozuara reale?</p>	20
<p>4. Kapacitetet operative të aplikuesit</p> <p>4.1 A ka aplikuesi përvojë të mjaftueshme në menaxhim të projekteve?</p> <p>4.2 A ka aplikuesi kapacitete të mjaftueshme operative në kuptim të stafit dhe pajisjeve?</p> <p>4.3 A ka aplikuesi aftësitë e domosdoshme për të menaxhuar buxhetin dhe për ta zhvilluar projektin?</p> <p>4.4 A ka aplikuesi përgatitjen dhe përvojën relevante për të trajtuar aspektet teknike dhe përmabjtësore të projektit të propozuar?</p>	20
<p>5. Qëndrueshmëria</p> <p>5.1 A ekzistojnë mjete dhe mekanizma adekuat për të siguruar qëndrueshmëri të projektit pas skadimit të financimit të CSIS?</p> <p>5.2 A parasheh projekti ndonjë aktivitet për ngritje të kapaciteteve?</p>	10

Faktorët e notimit	Nota e përgjithshme
1. Relevanca e projektit 1.1 A është identifikuar dhe përshkruar në mënyrë të qartë grupi i synuar? 1.2 A ofron projekti një përshkrim të qëndrueshëm të përfshirjes së komunitetit në vendimet e komunës? 1.3 A kanalizon propozimi çështjet rinore dhe gjinore? 1.4 A ka bashkërendim mes projektit dhe nismave të tjera dhe projekteve aktuale? 1.5 A ofron projekti zgjidhje kreative për çështjet e identifikuara? 1.6 A ka tenduar aplikuesi ta kontaktojë komunën për të kërkuar kontribut në natyrë?	30
Nota e përgjithshme	100

Kriteret e vlerësimit do të notohen sipas një shkalle gradimi 1 deri në 5 (1 = shumë dobët; 2 = dobët; 3 = adekuat; 4 = mirë; 5 = shumë mirë).

Shpenzimet për përgatitjen e aplikacionit nuk do të mbulohen nga financimi dhe nuk do duhej përfshirë në buxhet.

5.3. Hapi 3: Përzgjedhja/pranimi

Bazuar në vlerësimin dhe diskutimet e zhvilluara brenda tij, Komisioni Përzgjedhës do të vendosë nëse do të eliminojë apo pranojë, aplikacionin e dorëzuar për projekt.

Sa i përket përzgjedhjes/pranimit të projekteve, Komiteti mund të vendosë të ndjekë njërin nga mundësitë në vijim: (1) Komiteti Përzgjedhës do ta finalizojë vendimin e vet për të financuar projektet e përzgjedhura; apo (2) Komiteti Përzgjedhës do t'i përzgjedh projektet në mënyrë të përkohshme, dhe duke kushtëzuar dhënien e granteve me riformulimin dhe përmirësimin e tyre dhe me largimin e mangësive të identifikuara.

Nëse ndodh të ndiqet mënyra e dytë, Misioni i OSBE-së në Kosovë do t'i njoftojë OSHC-të potenciale me kërkesën e Komitetit dhe do t'ju ofrojë atyre udhëzimet e duhura për riformulim të projektit brenda një afati të caktuar kohor. Pa marrë parasysh nëse këto mangësi janë evituar apo jo, nuk do të ketë kërkesë tjetër për riformulim dhe Komiteti Përzgjedhës do ta merr vendimin e vet përfundimtar për ta përzgjedhur apo eliminuar projektin në bazë të aplikacioneve të riformuluara për projekte.

Rezultati i përzgjedhjes do të shpallet vetëm pas përzgjedhjes finale të përfituesve të projekteve.

6. LISTA KONTROLLUESE PËR APLIKIM

Para dërgimit të aplikacionit, sigurohuni se i keni të gjitha dokumentet e duhura:

- Aplikacionin e projektit dhe buxhetin e vulosur (nëse është në dispozicion)
- Kopje të certifikatës së regjistrimit (nëse është në dispozicion)
- Listën e tërë stafit menaxhues kryesor;
- CV-të e të gjithë punonjësve të projektit të propozuar;
- Marrëveshjen ose protokollin me shkrim, në rast se projekti propozohet nga një partneritet prej më shumë se një OSHC.

